



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 88 Datë 26.11.2007

PËR
MIRATIMIN E DETAJIMIT TË FONDIT Ë KUSHTËZUAR TË
QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT PËR BASHKINË E
QYTETIT TË KORÇËS

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës, "PËR MBI MIRATIMIN E DETAJIMIT TË FONDIT Ë KUSHTËZUAR TË QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT PËR BASHKINË E QYTETIT TË KORÇËS", bazuar në ligjin nr. 9723 dt.03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" neni 11, 12, ligjin nr 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 12, neni 32 pika "ç", ligjin nr 8379 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal", Ligji nr 9645 dt. 27.11.2006 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007", V.K.M. nr. 434 dt. 13.07.2007 "Për disa ndryshime në V.K.M. nr. 551 dt. 07.11.2002, "Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të Qeverisjes Vendore, për efekt page, e përcaktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të Qeverisjes Vendore", të ndryshuar", Udhëzimin nr 2 dt. 17.01.2007 i M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2007", Udhëzimin nr 353 dt.19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007", V.K.B. nr 76 dt. 15.10.2007 "Për ndryshimin e strukturës në administratën e Bashkisë", si dhe V.K.B. nr. 2 dt. 02.02.2007 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë detajimin shpërndarjen e fondit të kushtëzuar për Q.K.R. e Bashkisë Korçë për periudhën 29 Tetor 2007 - 31 Dhjetor 2007 si më poshtë:

a. Shpenzime për paga	Art 6000000	81.824 lekë
b. Shpenzime për sig. shoqërore dhe shëndetsore	Art 6010000	16.910 lekë
c. Shpenzime operative	Art 6020000	112.259 lekë

2. Struktura buxhetore e detajimit të fondit të sipërcituar do të jetë:

Pakësohet	04	04130 01	Art 6040000	- 210.993 lekë
Shtohet	04	04130 01	Art 6000000	+ 81.824 lekë
Shtohet	04	04130 01	Art 6010000	+ 16.910 lekë
Shtohet	04	04130 01	Art 6030000	+ 112.259 lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës në Bashki.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Raimonda Nase
Raimonda NASE